Fjalim i Kryetarit Obama lidhur me një fillim të ri, mbajtur në Universitetin e Kajros, Egjipt, me 4 qershor 2009

Kryetari Obama: Ju faleminderit shumë. Mirë dita. Jam i nderuar të jem në qytetin e përjetshëm të Kajros, dhe të jem i mirëpritur nga dy institucione të mrekullueshme. Për më shumë se një mijë vjet, Al-Azhar ka qëndruar si pishtar për studimin e Islamit; dhe për më shumë se një shekull, Universiteti i Kajros ka qenë burim i përparimit të Egjiptit. Dhe së bashku, ju përfaqësoni harmoninë në mes traditës dhe progresit. Ju jam mirënjohës për mirëpritjen tuaj, dhe mirëpritjen e popullit Egjiptian. Gjithashtu jam krenar ta sjell me vete dashamirësin e popullit Amerikan, dhe përshëndetjen paqësore nga komunitetet Myslimane në vendin tim: Assalaamu alaykum. (Duartrokitje.)

Po takohemi në një kohë me shumë tension në mes Shteteve të Bashkuara dhe Myslimanëve në tërë botën – tension i rrënjosur në forcat historike që tejkalon çdo debat aktual politik. Marrëdhënia ndërmjet Islamit dhe Perëndimit përfshinë shekuj të bashkëjetesës dhe bashkëpunimit, por gjithashtu konfliktit dhe luftërave religjioze. Së fundi, tensioni është ushqyer nga kolonializmi që ka mohuar të drejtat dhe mundësitë e shumë Myslimanëve, dhe Lufta e Ftohtë në të cilën shtetet me shumicë Myslimane kanë qenë shumë shpesh të trajtuara si përfaqësuese pa vëmendje ndaj aspiratave të tyre. Gjithashtu, ndryshimi i vrullshëm i sjellë nga modernizimi dhe globalizimi ka bërë që shumë Mysliman ta shikojnë Perëndimin si armik të traditave të Islamit.

Ekstremistët e dhunshëm i kanë shfrytëzuar këto tensione në minoritete Myslimane të vogla por të fuqishme. Sulmet e 11 Shtatorit 2001 dhe përpjekjet e vazhdueshme të këtyre ekstremistëve që të inkuadrohen në dhunën kundër qytetarëve kanë bërë që në vendin tim t'i shtyjnë disa ta shohin Islamin si armik të pa shmangshëm jo vetëm të Amerikës dhe shteteve të Perëndimit por gjithashtu edhe të drejtave të njeriut. Dhe të gjitha këto kanë shtuar më shumë frikën dhe më shumë mosbesimin.

Përderisa marrëdhënia jonë definohet nga dallimet tona, ne do tu japim fuqi atyre që mbjellin urrejtje më shumë se sa paqe, atyre të cilët përkrahin konfliktin më shumë se sa bashkëpunimin i cili do t'u ndihmonte të gjithë njerëzve tanë të arrijnë drejtësi dhe prosperitet. Dhe kjo fazë e dyshimeve dhe e mosmarrëveshjeve duhet të përfundoj.

Kam ardhur këtu në Kajro për të kërkuar një fillim të ri në mes Shteteve të Bashkuara dhe Myslimanëve në mbarë botën, një fillim të bazuar në interesat e përbashkëta dhe në respektin e përbashkët dhe një fillim të bazuar vetëm në të vërtetën që Amerika dhe Islami nuk janë ekskluziv dhe nuk duhet te jenë në garë.
Përkundrazi, ato përkojnë, dhe ndajnë principe të përbashkëta – principet e drejtësisë dhe progresit; tolerancës dhe dinjitetit të të gjitha qenieve njerëzore.

E pranoj se ndryshimet nuk ndodhin brenda natës. E di se ka pasur shumë publicitet rreth këtij fjalimi, por as edhe një fjalim i vetëm nuk mund t'i zhduk vitet e mosbesimit, dhe as unë nuk mund t'i përgjigjem, gjatë kohës që kam këtë pasdite, gjithë atyre pyetjeve komplekse që na kanë sjell deri në këtë pikë. Por jam i bindur që me qëllim që të ecim

përpara, ne duhet haptazi t'i themi njëri tjetrit gjërat që mbajmë në zemrat tona dhe që shumë shpesh janë thënë vetëm prapa dyerve të mbyllura. Duhet të ketë përpjekje të pandërprera për të dëgjuar njëri tjetrin; për të mësuar nga njëri tjetri; për të respektuar njëri tjetrin; dhe të kërkojmë gjërat e përbashkëta. Sikurse na thotë Kurani i Shenjtë "Ji i vetëdijshëm ndaj Zotit dhe gjithmonë thuaje të vërtetën." (Duartrokitje) Kjo është çka do të mundohem ta bëjë sot – ta flas të vërtetën më së miri që mundem, i përulur nga detyrat përpara nesh, dhe i sigurt në besimin tim që interesat që ne ndajmë si qenie njerëzore janë shumë më të fuqishme se sa forcat që na ndajnë.

Tani një pjesë e kësaj bindjeje është rrënjosur në përvojën time personale. Unë jam i Krishterë, por babai im rrjedh nga një familje Keniane që përfshinë gjenerata të Myslimanëve. Si djalosh, kam kaluar disa vjet në Indonezi dhe kam dëgjuar thirrjen e ezanit në agim dhe në rënie të muzgut. Si i ri, kam punuar në komunitete të Çikagos ku shumë njerëz kanë gjetur dinjitetin dhe paqen në besimin e tyre Mysliman.

Si student i historisë, gjithashtu di borxhin e civilizimit ndaj Islamit. Ishte Islami – në vendet si Al-Azhar – që ka sjellë dritën e diturisë gjatë aq shumë shekujve, duke shtrirë rrugën e Renesancës dhe Iluminizmit të Evropës. Ishte inovacioni në komunitetet Myslimane – (duartrokitje) – ishte inovacioni në komunitetet Myslimane që zhvilloi rendin e algjebrës; kompasin tonë magnetik dhe veglat e lundrimit; mjeshtërin tonë të të shkruarit dhe shtypshkrimit; kuptimin tonë se si përhapet sëmundja dhe si mund të shërohet ajo. Kultura Islamike na ka dhuruar harqet madhështore dhe shtizat e larta; poezitë e pafundme dhe muzikën e hareshme; bukurshkrimin elegant dhe vendet e soditjeve paqësore. Dhe gjatë gjithë historisë, Islami ka dëshmuar përmes fjalëve dhe veprave mundësitë e tolerancës religjioze dhe barazisë racore. (Duartrokitje).

Unë gjithashtu di se Islami ka qenë gjithmonë pjesë e historisë së Amerikës. Kombi i parë që ka njohur vendin tim ka qenë Maroku. Në nënshkrimin e Traktatit të Tripolit më 1796, Presidenti jonë i dytë, John Adams, shkroi, " Shtetet e Bashkuara nuk kanë në vete karakterin e armiqësisë ndaj ligjeve, religjionit ose qetësisë së Myslimanëve." Dhe që nga themelimi ynë, Myslimanët Amerikan kanë pasuruar Shtetet e Bashkuara. Ata kanë luftuar në luftërat tona, ata kanë shërbyer në qeverinë tonë, kanë qëndruar pranë të drejtave civile, kanë hapur biznese, kanë ligjëruar në universitet tona, janë dalluar në arenat tona sportive, kanë fituar çmime Nobel, kanë ndërtuar ndërtesat më të larta, dhe kanë ndezur Pishtarin e Olimpiadës. Dhe kur tani së fundi u zgjodh në Kongres i pari Amerikan Mysliman, ai u betua që ta mbroj Kushtetutën tonë duke përdorur të njëjtin Kuran të Shenjtë, të cilin e mbante një nga Baballarët tanë Themelues Thomas Jefferson-i në bibliotekën e tij personale,. (Duartrokitje.)

Kështu që e kam njohur Islamin në tri kontinente para se të vija në regjionin ku për herë të parë është shfaqur. Kjo përvojë udhëheq bindjen time që partneriteti ndërmjet Amerikës dhe Islamit duhet të bazohet në atë se çfarë është Islami, jo në atë çfarë nuk është. Dhe e konsideroj si pjesë të përgjegjësisë sime si President i Shteteve të Bashkuara të luftoj kundër stereotipeve negative të Islamit kudo që ato shfaqen. (Duartrokitje).

Por i njëjti parim duhet të zbatohet edhe për perceptimet Myslimane ndaj Amerikës. (Duartrokitje). Sikurse që myslimanët nuk i përkasin stereotipit të vrazhdë, as Amerika nuk është stereotip i vrazhdë i perandorisë me vetë-interes.
Shtetet e Bashkuara kanë qenë një ndër burimet zhvillimore më të mëdha që bota ka njohur ndonjëherë. Ne kemi lindur nga revolucioni kundër perandorisë. Ne jemi themeluar sipas idealit që të gjithë janë të krijuar të barabartë, dhe kemi derdhur gjak dhe kemi luftuar me shekuj që t'iu japim kuptimin këtyre fjalëve – brenda kufijve tanë, dhe në mbarë botën. Ne jemi të formësuar nga çdo kulturë, të tërhequr nga çdo fund i Tokës, dhe i jemi dedikuar një koncepti të thjeshtë: E pluribus unum – "Nga shumë, një."

Tani, shumë është folur për faktin që një Afrikan Amerikan me emrin Barack Hussein Obama mund të zgjidhej President. (Duartrokitje) Por rrëfimi im personal nuk është aq unik. Ëndrra e mundësisë për të gjithë njerëzit nuk është realizuar për çdonjërin në Amerikë, por premtimi i saj ekziston për të gjithë ata që vijnë në brigjet tona – dhe kjo përfshin afërsisht 7 milion Mysliman Amerikan në vendin tonë sot, të cilët gëzojnë të ardhurat dhe nivelet e arsimit që janë më të larta se sa mesatarja amerikane. (Duartrokitje)

Gjithashtu, liria në Amerikë është e pandashme nga liria për të ushtruar fenë.
Për këtë arsye ka xhami në çdo shtet të bashkësisë sonë, dhe mbi 1,200 xhami brenda kufijve tanë. Për këtë arsye qeveria e Shteteve të Bashkuara ka shkuar në gjykatë për të mbrojtur të drejtat e grave dhe vajzave për ta mbajtur hijabin dhe t'i dënojë ata që do ta mohonin këtë. (Duartrokitje).

Kështu që le të mos ketë dyshime: Islami është pjesë e Amerikës. Dhe besoj se Amerika mban në vete të vërtetën pa dallim race, religjioni, ose vendi në jetë, të gjithë ne ndajmë aspirata të përbashkëta – për të jetuar në paqe dhe siguri; për t'u shkolluar dhe për të punuar me dinjitet; për të dashur familjet tona, komunitetet tona, dhe Zotin tonë. Këto gjëra ne ndajmë. Kjo është shpresa e të gjithë njerëzimit.

Natyrisht, njohja e humanizmit të përbashkët është vetëm fillimi i detyrës sonë. Vetëm fjalët nuk mund t'i plotësojnë nevojat e popullit tonë. Këto nevoja do të plotësohen vetëm nëse ne veprojmë guximshëm në vitet në vazhdim; dhe nëse kuptojmë se sfidat me të cilat përballemi janë të përbashkëta, dhe dështimi jonë për t'i përballuar ato do të na lëndojë të gjithë ne.

Kemi mësuar nga përvojat e fundit që kur një sistem financiar dobësohet në një shtet, përparimi dobësohet çdo kund. Kur një grip i ri infekton një qenie njerëzore, të gjithë janë në rrezik. Kur një shtet ushtron në armë bërthamore, rreziku i sulmit nuklear rritet për të gjitha shtetet. Kur ekstremistët e dhunshëm operojnë në një shtrirje malesh, njerëzit janë në rrezik edhe përtej oqeanit. Kur të pafajshmit në Bosne dhe Darfur masakrohen, ajo është një njollë në ndërgjegjen tonë kolektive. (Duartrokitje) Kjo është çka do të thotë të ndash këtë botë në shekullin 21. Kjo është përgjegjësia që kemi si qenie njerëzore ndaj njëri tjetrit.

Dhe kjo është përgjegjësi e vështirë për ta mbajtur. Në historinë e njerëzimit shpesh ka pasur dëshmi të kombeve dhe fiseve – dhe, po, religjioneve – duke iu nënshtruar njëra tjetrës në kërkim të interesave të tyre personale. Por edhe në këtë epokë të re, qëndrime të tilla janë vetë-shkatërruese. Sipas ndërpavarësisë sonë, çdo rregull botërore që ngrit një shtet ose një grup njerëzish mbi tjetrin do të dështoj pa tjetër. Kështu që çfarëdo që mendojmë për të kaluarën, nuk duhet të jemi të burgosurit e saj. Problemeve tona duhen t'i qasemi përmes partneritetit; progresi jonë duhet të jetë i përbashkët. (Duartrokitje)

Tani, kjo nuk do të thotë që ne duhet të injorojmë burimet e tensionit. Në fakt, kjo sugjeron të kundërtën: Ne duhet t'i përballojmë tensionet në mënyrë të drejtë. Dhe prandaj në atë frymë, më lejoni të flas sa më qartë dhe më thjesht që mundem lidhur me disa çështje specifike të cilave besoj se më në fund duhet t'i kundërvihemi së bashku.

Çështja e parë që duhet t'i kundërvihemi është ekstremizmi i dhunshëm në të gjitha format e tij.

Në Ankara, e kam bërë të qartë se Amerika nuk është – dhe kurrë nuk do të jetë – në luftë me Islamin. (Duartrokitje.) Sidoqoftë, në mënyrë të papërkulshme ne do t'i kundërvihemi ekstremistëve të dhunshëm të cilët paraqesin një kërcënim serioz për sigurinë tonë – sepse ne refuzojmë të njëjtën gjë që të gjithë njerëzit e të gjitha besimeve e refuzojnë: vrasjen e burrave, grave dhe fëmijëve të pafajshëm. Dhe detyra ime e parë si President është të mbroj popullin amerikan.

Situata në Afganistan demonstron qëllimet e Amerikës, dhe nevojën tonë për të punuar së bashku. Më tepër se para shtatë vjetëve, Shtetet e Bashkuara ndoqën al Kaidën dhe Talibanin me përkrahjen e gjerë ndërkombëtare. Nuk është se kemi zgjedhur të bëjmë këtë; këtë e kemi bërë nga domosdoshmëria. Jam në dijeni se ende ka disa që do t'i vinin në dyshim apo madje arsyetonin ngjarjet e 11 shtatorit. Por të jemi të qartë: Al Kaida vrau afër 3,000 njerëz atë ditë. Viktimat ishin burra, gra dhe fëmijë të pafajshëm nga Amerika dhe nga shumë vende tjera që nuk kishin bërë asgjë për të lënduar dikë. Dhe përkundër kësaj al Kaida zgjodhi vrasjen e pamëshirshme të këtyre njerëzve, pranoi përgjegjësinë për sulmin, dhe madje edhe tani deklarojnë vendosmërinë e tyre për të vrarë në masë të gjerë. Ata kanë përkrahës në shumë vende dhe janë duke u munduar ta zgjerojnë rrjetin e tyre. Këto nuk janë mendime që duhet të debatohen; këto janë fakte që duhet të trajtohen.

Tani, mos të gabohemi: Ne nuk dëshirojmë t'i mbajmë trupat tona në Afganistan. Nuk shohim ushtri dhe nuk kërkojmë baza ushtarake atje. Është pikëlluese për Amerikën që t'i humbim djemt dhe vajzat tona të reja. Është e kushtueshme dhe politikisht e vështirë të vazhdohet ky konflikt. Ne me kënaqësi do ta sillnim çdo person nga trupat tona në shtëpi nëse do të siguroheshim që nuk do të kishte ekstremist të dhunshëm në Afganistan dhe tani në Pakistan të vendosur që të vrasin sa më tepër amerikan që ata munden. Por kjo gjë ende nuk është e mundur.

Dhe për këtë arsye ne jemi në partneritet me një koalicion prej 46 vendeve. Dhe përkundër shpenzimeve të përfshira, përkushtimi i Amerikës nuk do të dobësohet. Në

fakt, asnjëri nga ne nuk duhet t'i toleroj këta ekstremist. Ata kanë vrarë në shumë vende. Ata kanë vrarë njerëz të besimeve të ndryshme – por më tepër se çdo gjë, ata kanë vrarë mysliman. Veprimet e tyre janë të papajtueshme me të drejtat e njeriut, me zhvillimin e vendeve, dhe me Islamin. Kurani i Shenjtë mëson se kushdo që vret një të pafajshëm është sikurse të kishte vrarë gjithë njerëzimin. (Duartrokitje). Dhe Kurani i Shenjtë gjithashtu thotë se kushdo që shpëton një person është sikurse të ketë shpëtuar gjithë njerëzimin. (Duartrokitje.) Besimi i qëndrueshëm i më tepër se një miliard njerëzve është shumë më i madh se urrejtja e kufizuar e disave. Islami nuk është pjesë e problemit në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm – ai është një pjesë e rëndësishme e promovimit të paqes.

Tani, ne gjithashtu dimë se vetëm fuqia ushtarake nuk do të zgjidh problemet në Afganistan dhe Pakistan. Për këtë arsye ne planifikojmë të investojmë $1.5 miliard çdo vit gjatë pesë viteve të ardhshme që të bashkëpunojmë me pakistanezët në ndërtimin e shkollave, spitaleve, rrugëve, bizneseve dhe qindra miliona për t'i ndihmuar personat e zhvendosur. Për këtë arsye jemi duke dhënë më tepër se $2.8 miliard për të ndihmuar afganët në zhvillimin e ekonomisë së tyre dhe dhënien e shërbimeve nga të cilat njerëzit varen.

Më lejoni të adresoj edhe çështjen e Irakut. Ndryshe nga Afganistani, Iraku ka qenë një luftë e zgjedhjes që provokoi dallime të fuqishme në vendin tim dhe përreth botës. Edhe pse besoj se populli irakian përfundimisht është në një gjendje më të mirë pa tiraninë e Sadam Hyseinit, unë gjithashtu besoj se ngjarjet në Irak i kanë rikujtuar Amerikës nevojën për përdorimin e diplomacisë dhe ndërtimin e konsensusit ndërkombëtar për zgjidhjen e problemeve tona kurdo që është e mundur. (Duartrokitje). Në fakt, ne mund të rikujtojmë fjalët e Tomas Xhefersonit, i cili tha: "Shpresoj se mençuria jonë do të rritet me forcën tonë, dhe të na mësoj se sa më pak që përdorim forcën aq më e madhe ajo do të jetë."

Sot, Amerika ka një përgjegjësi të dyfishtë: t'i ndihmoj Irakut të arrij një të ardhme më të mirë – dhe t'ia lëmë Irakun irakianëve. Dhe këtë ia kam bë të qartë popullit irakian -- (duartrokitje) –ia kam bërë të qartë popullit irakian që nuk ndjekim baza, dhe nuk pretendojmë t'i shfrytëzojmë territorin apo burimet e tyre. Sovraniteti i Irakut është i tij. Dhe për këtë arsye kam urdhëruar largimin e brigadave tona luftarake deri në gushtin e ardhshëm. Për këtë arsye ne do ta respektojmë marrëveshjen tonë me qeverinë e zgjedhur demokratike të Irakut për largimin e trupave luftarake nga qytetet e Irakut deri në korrik, dhe largimin e të gjitha trupave tona nga Iraku deri në vitin 2012. (duartrokitje.) Ne do t'i ndihmojmë Irakut që të trajnoj forcat e veta të sigurisë dhe të zhvilloj ekonominë e vet. Por ne do ta përkrahim një Irak të sigurt dhe të bashkuar si një partner, dhe kurrë si një patron.

Dhe në fund, ashtu siç Amerika kurrë nuk mund të toleroj dhunën nga ekstremistët, ne kurrë nuk duhet t'i ndryshojmë ose harrojmë parimet tona. 11 shtatori ka qenë një traumë e jashtëzakonshme për vendin tonë. Frika dhe zemërimi që ka provokuar ka qenë e kuptueshme, por në disa raste, na ka detyruar të veprojmë kundër traditave dhe idealeve tona. Ne jemi duke marrë veprime konkrete për ta ndryshuar drejtimin. Në mënyrë të

qartë kam ndaluar përdorimin e torturës nga Shtetet e Bashkuara, dhe kam urdhëruar që burgu në limanin e Guantanamos të mbyllet deri në fillim të vitit të ardhshëm. (Duartrokitje.)

Kështu Amerika do ta mbroj veten, duke respektuar sovranitetin e vendeve dhe zbatimin e ligjit. Dhe këtë do ta bëjmë në partneritet me komunitetet myslimane të cilat gjithashtu janë të kërcënuara. Sa më shpejtë ekstremistët të izolohen dhe të mos jenë të mirëseardhur në komunitetet myslimane, aq më shpejtë të gjithë do të jemi më të sigurt.

Burimi i dytë më i madh i tensionit që ne duhet ta diskutojmë është situata në mes të izraelitëve, palestinezëve dhe botës arabe.

Lidhjet e forta të Amerikës me Izraelin janë mirë të njohura. Kjo lidhje është e pathyeshme. Është e bazuar në lidhjet kulturore dhe historike, dhe njohjen se aspirata për një atdhe hebre është e rrënjosur në një histori tragjike që nuk mund të mohohet.

Përreth botës, populli hebre është persekutuar me shekuj dhe anti-semitizmi në Evropë ka arritur kulmin në Holokaustin e pashembullt. Nesër, unë do ta vizitoj Buchenwald-in, që ishte pjesë e rrjetit të kampeve ku Hebrenjtë u robëruan, torturuan, pushkatuan dhe u vranë me gaz nga Rajhu i Tretë. Gjashtë milion hebrenj u vranë – më shumë se e gjithë popullsia hebraike e Izraelit të sotëm. Mohimi i këtij fakti është i pabazë, është injorant, dhe është urrejtës. Kërcënimi i Izraelit me shkatërrim – ose përsëritja e stereotipeve të vrazhda për hebrenjtë – është thellësisht e gabuar, dhe shërben vetëm për të ngulitur në mendjet e izraelitëve këtë kujtimin më të dhimbshëm duke parandaluar paqen që populli i këtij regjioni e meriton.

Në anën tjetër, është gjithashtu e pamohueshme se populli palestinez – myslimanët dhe të krishterët – kanë vuajtur në kërkim të atdheut. Për më tepër se 60 vjet ata kanë duruar dhembjen e dislokimit. Shumë nga ta presin në kampet e refugjatëve në Bregun Perëndimor, Gaza, dhe në vendet fqinje për një jetë paqësore dhe të sigurt që kurrë nuk kanë mundur ta jetojnë. Ata i durojnë poshtërimet ditore – të vogla dhe të mëdha – që vijnë me pushtimin. Kështu që le të mos ketë dyshime: Situata për popullin palestinez është e patolerueshme. Dhe Amerika nuk do t'ia kthej shpinën aspiratës legjitime të palestinezëve për dinjitet, mundësi, dhe për një shtet të tyre. (duartrokitje.)

Për dekada, ka ekzistuar një status kuo: dy popuj me aspirata legjitime, secili me një histori të dhimbshme që e bën kompromisin të pakapshëm. Është lehtë t'i drejtojmë gishtat – për palestinezët që ta drejtojnë gishtin kah zhvendosja e sjellë nga themelimi i Izraelit, dhe për izraelitët ta drejtojnë gishtin kah armiqësia dhe sulmet e përhershme përgjatë historisë së tijj brenda kufijve por edhe jashtë tij. Por nëse e shohim këtë konflikt vetëm nga njëra ose ana tjetër, atëherë do të jemi të verbër ndaj të vërtetës: Zgjidhja e vetme është që aspiratat e të dyja anëve të arrihen përmes dy shteteve, ku izraelitët dhe palestinezët do të jetonin në paqe dhe siguri. (Duartrokitje.)

Kjo është në interesin e Izraelit. Në interesin e Palestinës, në interesin e Amerikës, dhe në interesin e botës. Dhe për këtë arsye qëllimi im është që personalisht ta ndjek këtë

përfundim me gjithë durimin dhe përkushtimin që kjo detyrë kërkon. (Duartrokitje.) Obligimet – obligimet, për të cilat palët janë pajtuar sipas hartës rrugore, janë të qarta. Që të arrihet paqja, është koha që ata – dhe të gjithë ne – t'i përmbushim përgjegjësitë tona.

Palestinezët duhet ta braktisin dhunën. Rezistenca përmes dhunës dhe vrasjes është e gabuar dhe nuk ka sukses. Për shekuj, populli zezak në Amerikë ka vuajtur kamxhikun si skllevër dhe poshtërimin e segregacionit. Por nuk ka qenë dhuna që fitoi të drejtat e plota dhe të barabarta. Ka qenë këmbëngulja paqësore dhe e vendosur mbi idealet në qendër të krijimit të Amerikës. Ky tregim i njëjtë mund të tregohet nga njerëzit prej Afrikës jugore deri Azinë jugore; prej Evropës lindore deri në Indonezi. Është një tregim me një të vërtetë të thjeshtë: se dhuna është një rrugë pa dalje. Ajo nuk është shenjë as e guximit as e forcës për të hedhur raketa mbi fëmijët e fjetur, ose për të shpërthyer autobusin përplot me gra të moshuara. Kjo nuk është mënyra për të fituar autoritetin moral; kjo është mënyra se si ai dorëzohet.

Tani është koha që palestinezët të fokusohen në atë që ata mund ta ndërtojnë. Autoriteti palestinez duhet të zhvilloj kapacitetin e tij për të qeverisur, me institucionet që iu shërbejnë nevojave të qytetarëve të tyre. Hamasi ka përkrahjen e disa palestinezëve, por ata duhet edhe të pranojnë se kanë përgjegjësi. Që ta luajnë rolin drejt realizimit të aspiratave palestineze, që ta bashkojnë popullin palestinez, Hamasi duhet ta ndërpres dhunën, t'i njoh marrëveshjet e kaluara, dhe ta njoh të drejtën e Izraelit për të ekzistuar.

Në të njëjtën kohë, izraelitët duhet të pranojnë se ashtu siç e drejta e Izraelit për të ekzistuar nuk mund të mohohet, as ajo e palestinezëve nuk mund të mohohet. Shtetet e Bashkuara nuk pranojnë legjitimitetin e vendbanimeve të vazhdueshme izraelite. (Duartrokitje). Ky ndërtim shkel marrëveshjet e mëparshme dhe zvogëlon përpjekjet për arritjen e paqes. Është koha që këto vendbanime të ndërpriten. (Duartrokitje.)

Dhe Izraeli gjithashtu duhet ta përmbush obligimin e tij për tu siguruar që palestinezët mund të jetojnë, të punojnë dhe ta zhvillojnë shoqërinë e tyre. Ashtu siç shkatërron familjet palestineze, kriza e vazhdueshme humanitare në Gaza nuk i shërben sigurisë së Izraelit; dhe as mungesa e vazhdueshme e mundësive në Bregun Perëndimor. Zhvillimi në jetën e përditshme të popullit palestinez duhet të jetë pjesa kritike e rrugës drejt paqes, dhe Izraeli duhet të ndërmarrë hapa konkret për ta mundësuar një zhvillim të tillë.

Dhe në fund, shtetet arabe duhet të pranojnë se Iniciative Paqësore Arabe ka qenë një fillim i rëndësishëm, por jo edhe fundi i përgjegjësive të tyre. Konflikti arabo-izraelit nuk duhet më të përdoret për ta hutuar popullin e vendeve arabe nga problemet tjera. Përkundrazi, duhet të jetë një shkas për veprim për ta ndihmuar popullin palestinez që t'í zhvilloi institucionet që do ta mbështesin shtetin e tyre, të njoh legjitimitetin e Izraelit, dhe të zgjedh përparimin e jo fokusin vetë-shkatërrues në të kaluarën.

Amerika do t'i radhitë politikat tona me ata të cilët ndjekin paqen, dhe ne do t'ia themi publikisht atë që ua themi privatisht izraelitëve, palestinezëve dhe arabëve. (Duartrokitje.) Ne nuk mund të imponojmë paqen. Por jozyrtarisht, shumë mysliman e pranojnë që Izraeli nuk do të shkoj. Në të njëjtën mënyrë, shumë izraelit pranojnë

nevojën për një shtet palestinez. Është koha që ne të veprojmë për atë që çdonjëri e di si të vërtetë.

Shumë lot janë derdhur. Shumë gjak është derdhur. Të gjithë ne kemi përgjegjësi për të punuar për ditën kur nënat e izraelitëve dhe palestinezëve mund t'i shohin fëmijët e tyre duke u rritur pa frikë; kur Toka e Shenjtë e tri besimeve të mëdha të jetë vendi i paqes që Zoti e ka bërë për këtë qëllim; kur Jerusalemi të jetë një vend i sigurt dhe i përhershëm për hebrenjtë, të krishterët dhe myslimanët, dhe një vend për të gjithë fëmijët e Abrahamit për t'u përzier në mënyrë paqësore së bashku sikurse në tregimin e Isra-s -- (Duartrokitje) – sikurse në tregimin e Isra-s, kur Mojsiu, Jezui, dhe Muhamedi, paqja të jetë mbi ta, u bashkuan në lutje. (Duartrokitje.)

Burimi i tretë i tensionit është interesi jonë i përbashkët në të drejtat dhe përgjegjësitë e vendeve për armët bërthamore.

Kjo çështje ka qenë një burim i tensionit në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Republikës Islamike të Iranit. Për shumë vite, Irani ka definuar veten pjesërisht me kundërshtimin e vet ndaj vendit tim, dhe në fakt është një histori e zhurmshme në mes nesh. Në mesin e Luftës së Ftohtë, Shtetet e Bashkuara kanë luajtur një rol në përmbysjen e qeverisë së zgjedhur demokratike iraniane. Që nga revolucioni islamik, Irani ka luajtur një rol në aktet e pengmarrjes dhe dhunës kundër trupave dhe civilëve të SHBA-së. Kjo histori është shumë mirë e njohur. Më mirë se të mbetet e mbërthyer në të kaluarën , iu kam bërë të qartë udhëheqësve dhe popullit iranian që vendi im është i përgatitur të shkoj përpara. Pyetja tani nuk është se kundër kujt është Irani, por çfarë ardhmërie dëshiron të ndërtoj.

Unë e pranoj se do të jetë e vështirë të tejkalohen dekadat e mosbesimit, por ne do të vazhdojmë me guxim, korrektësi dhe vendosmëri. Do të jenë shumë çështje për tu diskutuar në mes të dy vendeve tona, dhe ne dëshirojmë të shkojmë përpara pa parakushte në bazë të respektit të dyanshëm. Por është e qartë për të gjithë të interesuarit se kur vije çështja tek armët bërthamore, ne kemi arritur një pikë vendimtare. Kjo nuk është thjesht për interesat e Amerikës. Kjo ka të bëj me parandalimin e garës së armëve bërthamore në Lindjen e Mesme që do ta shpinte këtë regjion dhe gjithë botën drejt një rruge jashtëzakonisht të rrezikshme.

Unë i kuptoj ata që protestojnë se disa vende kanë armë ndërsa të tjerat jo. Asnjë vend nuk duhet të shikoj se cili vend mban armë bërthamore. Dhe për këtë arsye unë fuqimisht kam ritheksuar përkushtimin e Amerikës për kërkimin e një bote në të cilën asnjë vend nuk mban armë bërthamore. (Duartrokitje). Dhe çdo vend – përfshirë Iranin – duhet të ketë të drejtën për të pasur qasje në fuqinë paqësore bërthamore nëse i përmbahet përgjegjësive sipas Marrëveshjes për Mos-Shtim bërthamor. Ky përkushtim është në bërthamën e marrëveshjes, dhe duhet të mbahet për të gjithë që i përmbahen asaj në tërësi. Dhe shpresoj se të gjitha vendet në regjion mund të bëjnë pjesë në këtë qëllim.

Çështja e katërt që do ta adresoj është demokracia. (Duartrokitje.)

E di – E di se ka pasur kundërthënie lidhur me promovimin e demokracisë në vitet e fundit, dhe pjesa më e madhe e kësaj kundërthënie ka të bëjë me luftën në Irak. Kështu që, më lejoni të jem i qartë: Asnjë sistem qeverisës nuk mund dhe nuk duhet të imponohet nga asnjë vend.

Sidoqoftë, kjo nuk zvogëlon përkushtimin tim drejt qeverive që pasqyrojnë vullnetin e popullit. Secili vend e jetëson këtë parim në mënyrën e vet, bazuar në traditat e popullit të vet. Amerika nuk pretendon ta njoh atë që është më e mira për të gjithë, ashtu sikurse nuk mund të pretendojmë ta qëllojmë rezultatin e një zgjedhjeje demokratike. Por unë kam një besim të pathyeshëm se të gjithë njerëzit kanë etje për disa gjëra të caktuara: aftësinë për të shprehur mendimin e tyre dhe për të folur për mënyrën se si qeverisen; besimi në zbatimin e ligjit dhe administrimin e barabartë të drejtësisë; qeverinë që është transparente dhe që nuk vjedh nga populli; të drejtën të jetojnë ashtu si dëshirojnë. Këto nuk janë vetëm idetë amerikane; ato janë të drejta njerëzore. Dhe për këtë arsye ne do t'i mbështesim ato gjithkund. (Duartrokitje.)

Tani, nuk ekziston një vijë e drejtë për të realizuar këtë premtim. Por kjo është shumë e qartë: Qeveritë që mbrojnë këto të drejta përfundimisht janë më stabile, të suksesshme dhe të sigurta. Duke shtypur idetë nuk arrihet të largohen ato. Amerika respekton të drejtën e të gjithë zërave të paqes dhe respektimit të ligjit që të dëgjohen në të gjithë botën, edhe nëse nuk pajtohemi me to. Dhe ne do t'i mirëpresim të gjitha qeveritë e zgjedhura paqësore – me kusht që ato do të qeverisin me respekt për gjithë popullin e tyre.

Kjo pikë e fundit është e rëndësishme sepse ekzistojnë disa të cilët përkrahin demokracinë vetëm kur nuk janë në pushtet; posa të marrin pushtetin, ata janë të pamëshirshëm në shtypjen e të drejtave të të tjerëve. (Duartrokitje.) Prandaj kudo që të ndodh, qeveria e popullit dhe nga populli cakton një standard të vetëm për të gjithë ata që do të ishin në pushtet: Duhet të mirëmbani pushtetin tuaj përmes pajtimit, jo shtypjes; duhet t'i respektoni të drejtat e pakicave, dhe të merrni pjesë me shpirtin e tolerancës dhe kompromisit; duhet t'i vendosni interesat e popullit tuaj dhe detyrat legjitime të procesit politik mbi partinë tuaj. Pa këto elemente përbërëse, vetëm zgjedhjet nuk përbëjnë demokracinë e vërtetë.

ANËTAR I AUDIENCËS: Barack Obama, ne të duam!

KRYETARI OBAMA: Faleminderit. (Duartrokitje.) Çështja e pestë që duhet ta adresojmë së bashku është liria fetare.

Islami ka një traditë krenare të tolerancës. Ne e shohim atë në historinë e Andaluzisë dhe Kordobas gjatë Inkuizicionit. E kam parë vetë si fëmijë në Indonezi, ku të krishterët e devotshëm luteshin lirshëm në një vend me shumicë dërmuese myslimane. Ky është shpirti që na duhet sot. Popujt në çdo vend duhet të jenë të lirë të zgjedhin dhe ta jetojnë besimin e tyre bazuar në bindjet e mendjes dhe zemrës dhe shpirtit. Kjo tolerancë është thelbësore që religjioni të lulëzoj, por është duke u sfiduar në shumë mënyra të ndryshme.

Në mesin e disa myslimanëve, ekziston një tendencë shqetësuese për të matur besimin e dikujt duke refuzuar besimin e dikujt tjetër. Pasuria e llojllojshmërisë fetare duhet të mbështetet – pa marrë parasysh nëse është për Maronitët në Liban ose Koptët në Egjipt. (Duartrokitje.) Dhe nëse jemi të sinqertë, vijat e fajit duhet të mbyllen në mesin e myslimanëve, si dhe ndarjet në mes të sunitëve dhe shiitëve kanë shpënë në dhunë tragjike, veçanërisht në Irak.

Liria e religjionit është qendrore në aftësinë e popujve që të jetojnë së bashku. Ne gjithmonë duhet t'i kërkojmë mënyrat se si ta mbrojmë atë. Për shembull, në Shtetet e Bashkuara, rregullat për bamirësi iu kanë bërë myslimanëve më të vështirë përmbushjen e obligimit fetar. Për këtë arsye unë jam i përkushtuar të punoj me myslimanët amerikan që të sigurohet përmbushja e zakatit të tyre.

Gjithashtu, është e rëndësishme për vendet perëndimore që t'i shmangen pengimit të qytetarëve mysliman në ushtrimin e religjionit ashtu siç e shohin ata të përshtatshme – për shembull, duke diktuar çfarë rrobe duhet të vesh një grua myslimane. Ne nuk mund ta maskojmë armiqësinë ndaj ndonjë religjioni pas shtirjes për liberalizëm.

Në fakt, besimi duhet të na bashkoj, dhe për këtë arsye jemi duke përgatitur projekte shërbyese në Amerikë për t'i sjellë së bashku të krishterët, myslimanët, dhe hebrenjtë. Për këtë arsye ne mirëpresim përpjekjet si ajo për dialog ndër-fetar të Mbretit Abdullah të Arabisë Saudite dhe udhëheqësve të Turqisë në Aleancën e Civilizimeve. Në gjithë botën, ne mund ta shndërrojmë dialogun në shërbim ndërfetar, ashtu që urat në mes të popujve të shpijnë te veprimet – pa marrë parasysh nëse luftohet malaria në Afrikë, ose jepet ndihma pas një fatkeqësie natyrore.

Çështja e gjashtë – çështja e gjashtë që dua ta adresoj është të drejtat e gruas. (Duartrokitje.) E di –- E di – dhe nga kjo audiencë mund të thuhet se ekziston një debat i shëndosh për këtë çështje. Unë hedh poshtë pikëpamjen e disave në Perëndim se një grua që zgjedh të mbulon flokët e saj është disi më pak e barabartë, por unë besoj se një gruaje që i mohohet arsimimi asaj i mohohet barazia. (Duartrokitje.) Dhe nuk është rastësi që vendet ku gratë janë të arsimuara kanë mundësi shumë më të mëdha të kenë prosperitet.

Tani, të jem i qartë: Çështjet e barazisë së grave nuk janë thjesht një çështje për Islamin. Në Turqi, Pakistan, Bangladesh, Indonezi, ne kemi parë vendet me shumicë myslimane që kanë zgjedhur gruan për të udhëhequr. Ndërkohë, përpjekja për barazinë e grave vazhdon në shumë aspekte të jetës amerikane, dhe në vendet në tërë botën.

Jam i bindur se vajzat tona mund të kontribuojnë për shoqërinë aq sa edhe djemtë tanë. (Duartrokitje.) Prosperiteti ynë i përbashkët do të avancohet duke i mundësuar tërë njerëzimit – burra dhe gra – të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Nuk besoj se gratë duhet të bëjnë zgjedhje të njëjta sikurse burrat në mënyrë që të jenë të barabarta, dhe unë i respektoj ato gra të cilat zgjedhin të jetojnë jetën e tyre në rolet tradicionale. Por duhet të jetë zgjedhja e tyre. Dhe për këtë arsye Shtetet e Bashkuara do të bashkëpunojnë me çdo vend me shumicë myslimane për të përkrahur shkrimin dhe leximin për vajzat, dhe për t'i

ndihmuar gratë të punësohen përmes mikro-financimit që iu ndihmon njerëzve t'i jetojnë ëndrrat e tyre. (Duartrokitje.)

Në fund, dua të diskutoj për zhvillimin dhe mundësinë ekonomike.

E di që për shumë njerëz, fytyra e globalizimit është kundërthënëse. Interneti dhe televizioni mund të sjellin njohuri dhe informata, por edhe seksualitet fyes dhe dhunë të pamendët në shtëpi. Tregtia mund të sjell pasuri dhe mundësi të reja, por gjithashtu edhe shumë përçarje dhe ndryshim në komunitete. Në të gjitha vendet – përfshirë Amerikën – ky ndryshim mund të sjell frikë. Frikën se për shkak të modernizimit ne humbim kontrollin ndaj zgjedhjeve tona ekonomike, politikave tona, dhe që është më me rëndësi identitetit tonë – ato gjëra që ne më së shumti i duam për komunitetet tona, familjet tona, traditat tona, dhe besimin tonë.

Por gjithashtu e di se përparimi njerëzor nuk mund të mohohet. Nuk duhet të ketë kundërthënie në mes të zhvillimit dhe traditës. Vendet si Japonia dhe Korea jugore i kanë zhvilluar ekonomitë e tyre në masë të madhe duke mbajtur kulturat e tyre dalluese. E njëjta është e vërtetë për zhvillimin mahnitës të vendeve me shumicë myslimane prej Kuala Lumpurit deri në Dubai. Në kohët antike dhe në kohën tonë, komunitetet myslimane kanë qenë në krye të inovacionit dhe edukimit.

Dhe kjo është e rëndësishme sepse asnjë strategji zhvillimore nuk mund të bazohet vetëm në atë që vjen nga toka, dhe as nuk mund të mbahet derisa të rinjët janë të papunë. Shumë shtete të Gjirit kanë gëzuar pasuri të mëdha për shkak të naftës, dhe disa do të fillojnë ta fokusojnë atë në një zhvillim më të gjerë. Por të gjithë ne duhet të pranojmë se arsimi dhe inovacioni do të jenë valuta e shekullit 21 -- (Duartrokitje) – dhe në shumë komunitete myslimane, ende ekzistojnë investime të vogla në këto fusha. Jam duke theksuar një investim të tillë në vet vendin tim. Dhe derisa Amerika në të kaluarën është fokusuar në naftë dhe gaz kur është fjala për këtë pjesë të botës, tani ne kërkojmë një angazhim më të gjerë.

Nga aspekti i arsimit, ne do t'i zgjerojmë programet shkëmbyese, dhe do t'i rrisim bursat, sikurse ajo që e solli babain tim në Amerikë. (Duartrokitje.) Në të njëjtën kohë, ne do të inkurajojmë më shumë amerikanë të studiojnë në komunitetet myslimane. Dhe do të bëjmë që studentët premtues mysliman të kryejnë praktikën në Amerikë; do të investojmë në mësimin online për mësuesit dhe fëmijët në tërë botën; dhe do ta krijomë një rrjet të ri online, kështu që një i ri nga Kanzasi të mund të komunikoj menjëherë me një të ri nga Kairo.

Nga aspekti i zhvillimit ekonomik, ne do të krijojmë një korpus të ri të vullnetarëve afarist për të bashkëpunuar me homologët e tyre nga vendet me shumicë myslimane. Dhe unë do të jem mikpritës në Samitin e Ndërmarrësisë këtë vit për të identifikuar se si mund t'i forcojmë lidhjet në mes të udhëheqësve afarist, fondacioneve dhe ndërmarrësve shoqëror të Shteteve të Bashkuara dhe komuniteteve myslimane në tërë botën.
Nga aspekti i shkencës dhe teknologjisë, ne do të krijojmë një fond të ri për përkrahjen e zhvillimit teknologjik në vendet me shumicë myslimane, dhe do të ndihmojmë në

transferimin e ideve në treg ashtu që të krijohen më shumë vende pune. Ne do të hapim qendra për përsosmëri shkencore në Afrikë, Lindje të Mesme dhe Azi Juglindore, dhe do të emërojmë emisarë të rinj të shkencës që të bashkëpunojnë lidhur me programet që zhvillojnë burimet e reja të energjisë, krijojnë punë ambientale, digjitalizojnë shënime, pastrojnë ujin, dhe rrisin të mbjellat e reja. Sot unë bëj të ditur një përpjekje të re globale me Organizatën e Konferencës Islamike për zhdukjen e polios. Dhe ne do të zgjerojmë partneritetin me komunitetet myslimane për promovimin e shëndetit fëmijëror dhe amënor.

Të gjitha këto gjëra duhet të bëhen në partneritet. Amerikanët janë të gatshëm t'i bashkëngjiten qytetarëve dhe qeverive; organizatave të komunitetit, udhëheqësve fetar, dhe bizneseve në komunitetet myslimane në tërë botën për tu ndihmuar njerëzve tanë në kërkim të një jete më të mirë.

Çështjet që i kam përshkruar nuk do të jenë të lehta të adresohen. Por ne kemi përgjegjësinë për tu bashkuar në emër të botës që ne kërkojmë – një bote ku ekstremistët nuk kërcënojmë më njerëzit tanë, dhe trupat amerikane mund të kthehen në shtëpi; një botë ku izraelitët dhe palestinezët janë të sigurtë në shtetin e tyre, dhe energjia bërthamore përdoret për qëllime paqësore; një botë ku qeveritë i shërbejnë qytetarëve të tyre, dhe të drejtat e të gjithë fëmijëve të Zotit respektohen. Ato janë interesa të përbashkëta. Ajo është bota që ne e kërkojmë. Por këtë mund ta arrijmë vetëm së bashku.

Unë e di se ka shumë – Musliman dhe jo-Mysliman – të cilët e vënë në dyshim realizimin e këtij fillimi të ri. Disa janë të etur të ndezin flakën e ndarjes, dhe të pengojnë rrugën e përparimit. Disa sugjerojnë se nuk ia vlen të përpiqemi – se fati jonë është të mos pajtohemi, dhe civilizimet janë të gjykuara të përplasen. Disa janë thjesht skeptik që një ndryshim real mund të ndodh. Ka aq shumë frikë, aq shumë mosbesim që është krijuar gjatë viteve. Por nëse ne zgjedhim të lidhemi me të kaluarën, ne kurrë nuk do të lëvizim përpara. Dhe unë dëshiroj që veçanërisht t'ua them të rinjve të secilit besim, në çdo vend -- ju, më shumë se çdonjëri, keni aftësinë ta ri-imagjinoni botën, ta ri-bëni këtë botë.

Të gjithë ne e ndajmë këtë botë për një moment të shkurtë në kohë. Pyetja është nëse dëshirojmë ta kalojmë atë kohë duke u fokusuar në atë që na ndanë, apo dëshirojmë të angazhohemi në një përpjekje – një përpjekje të qëndrueshme – të gjejmë gjërat e përbashkëta, të fokusohemi në ardhmërinë që ne kërkojmë për fëmijët tanë, dhe të respektojmë dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore.

Është më lehtë të fillohen luftërat sesa të përfundohen. Është më lehtë të fajësohen të tjerët sesa të shikohet brenda nesh. Është më lehtë të shihen gjërat e ndryshme tek dikush sesa t'i gjejmë gjërat e përbashkëta. Por ne duhet të zgjedhim rrugën e drejtë, jo vetëm rrugën e lehtë. Ekziston një rregull që është në zemër të secilit religjion – që ne u bëjmë të tjerëve atë që ne do të donim që ata të na bëjnë neve. (Duartrokitje.) Kjo e vërtetë ngrihet përtej vendeve dhe popujve – një besim që nuk është i ri; që nuk është i zi ose i bardhë ose ngjyrë kafeje; që nuk është i krishterë, mysliman ose hebre. Është një besim që rrah në djepin e civilizimit, dhe ende rrah në zemrat e miliarda njerëzve në tërë botën. Është një besim në njerëzit tjerë, dhe është ajo që mua më ka sjellë sot këtu.

Ne kemi fuqinë ta bëjmë botën që e dëshirojmë, por vetëm nëse kemi guximin ta bëjmë një fillim të ri, duke pasur parasysh atë çka është shkruar.

Kurani i Shenjtë na thotë: "O njerëzim! Ne ju kemi krijuar mashkull dhe femër; dhe ne ju kemi bërë popuj dhe fise ashtu që të mund të njihni njëri tjetrin."

Talmudi na thotë: "Tërë Torah është për qëllimin e promovimit të paqes."

Bibla e Shenjtë na thotë: "Të bekuar janë paqeruajtësit, sepse ata do të quhen djemtë e Zotit." (Duartrokitje.)

Njerëzit e botës mund të jetojnë së bashku në paqe. Ne e dimë që ky është vizioni i Zotit. Tani kjo duhet të jetë puna jonë në Tokë.

Faleminderit. Qoftë paqja e Zotit mbi ju. Faleminderit shumë. Faleminderit. (Duartrokitje.)

FUND 2:05 P.M. (lokal)